



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:261072

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05709932

KPPP.nr. 2026/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit NLB Banka Sh.A., me numër të regjistrimit të biznesit 70053484 dhe me seli në Prishtinë, rr. "Ukshin Hoti", nr. 124, kundër debitorëve; 1. "SH.R.M." B.I., dhe me emër tregtar Bio Green House Ferma, me numër unik identifikues 811371137 dhe seli në Prishtinë, rr. "Drenicës", nr. 14/A; 2. M.K., me numër personal ... dhe me adresë në Prishtinë, rr. "Nazmi Gafurri", p.n.; 3. N.D., me numër personal ... dhe me adresë në Prishtinë, rr. "Bulevardi Dëshmorët e Kombit", nr. 66-11; 4. SH.M. me adresë në Prishtinë, rr. "Drenicës", nr. 14/A, si dhe 5. M.D., me numër personal ... dhe me adresë Prishtinë, rr. "Bulevardi Dëshmorët e Kombit", nr. 6-10, duke vendosur sipas prapësimit të debitorëve M.K. dhe N.D., të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1853/23, të lejuar me datë 10.11.2023 nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë, me datë 20.05.2024, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorëve M.K. dhe N.D., i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1853/23, të lejuar me datë 10.11.2023 nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr. 1853/23, i lejuar me datë 10.11.2023 nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit NLB Banka Sh.A., ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1853/23, të datës 10.11.2023, kundër debitorëve "SH.R.M." B.I., dhe

me emër tregtar Bio Green House Ferma, M.K., N.D., SH.M., M.D., ashtu që janë detyruar të njëjtit, që mbi bazën e dokumentit përmbartimor Marrëveshjes mbi pengun Nr. K0121/1213, e datës 08.04.2021, për sigurimin e kërkesave nga Kontrata për kredi për bujqësi Nr. K0121/1213, e datës 08.04.2021, e regjistruar në regjistrin e pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20211101-162, t'ia paguajnë kreditorit borxhin në vlerë prej EUR 32,648.99 (me shkronja: tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë euro e nëntëdhjetë e nëntë cent), duke përfshirë edhe kamatën e rregullt dhe kamatë vonesën e arritur deri më tani, si dhe kamatat që do të llogariten deri në përfundim të procedurës.

Debitorët M.K. dhe N.D., brenda afatit ligjor kanë ushtruar prapësim me të cilin e kanë kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se në cilësinë e bashkë huamarrësit kanë lidhur kontratën për kredi për bujqësi në emër të Bio Green House Ferma, e që në vitin 2020 kanë hapur një biznes për prodhimin e perimeve në sera të mbuluara, mirëpo kanë pasur ngecje për shkak të pandemisë ku i'u është pamundësuar realizimi i suksesshëm i veprimtarisë. Më tej, ka theksuar se për këtë e kanë njoftuar edhe kreditorin dhe se me datë 05.09.2021 kanë paguar këstin vjetor në vlerë prej 4,312.00 € dhe kamatën e rregullt në vlerë prej 1,188.00 €. Ka shtuar se në kontratë nuk ka të caktuar ndonjë datë të pagesës së këstit vjetor por vetëm datën përfundimtare të arritjes së kredisë e që është data 05.03.2023, ashtu që deri në atë datë do të paguajnë në tërësi kredinë. I kanë propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorëve, ndërsa urdhri përmbartimor të refuzohet si jo i bazuar.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar prapësimin e debitorëve me arsyetimin se fillimisht prapësimi i debitorëve është i nënshkruar vetëm nga njëri debitor. Ka shtuar se debitorët që kanë paraqitur prapësimin kanë qenë nënshkrues të marrëveshjeve të kërdisë në cilësinë e palëve kreditore/bashkëhuamarrëse, me ç'rast kanë marrë përsipër obligimet dhe detyrimet si dhe janë pajtuar me të gjitha kushtet të cilat rrjedhin si rezultat i këtyre marrëveshjeve. Tutje, ka shtuar se debitorët janë pajtuar që pagesa e kësteve të kredisë të bëhet sipas planit të amortizimit e në rast të mos përmbushjes me rregull dhe në kohë, kreditori ka të drejtë të shfrytëzojë të gjitha instrumentet e sigurisë, e të kërkojë edhe pagesën e borxhit të arritur dhe të pa arritur. Duke qenë se debitorët me asnjë provë nuk e kanë argumentuar bazën e prapësimit me prova, ashtu sic përcaktohet me nenin 69, par. 4 të LPP-së, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke

iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për arsyt si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: “*Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*”, ndërsa sipas nenit 22, pika 1.7 përcaktohet se “*kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit*”, ndërsa, me nenin 5, paragrafi 2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se dokument përmbartues paraqet: “*...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...*”. Në anën tjetër, me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se “*Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”.

Gjykata duke vlerësuar Marrëveshjen mbi pengun Nr. K0121/1213, e datës 08.04.2021, për sigurimin e kërkesave nga Kontrata për kredi për bujqësi Nr. K0121/1213, e datës 08.04.2021, gjeti se e njëjta është hartuar në formën e paraparë me ligj dhe është regjistruar në regjistrat publik, fakt ky që vërtetohet nga Konfirmimi mbi regjistrimit e pengut me R-20211101-162, dhe i është bashkangjitur propozimit për përmbartim në kopje të vërtetuar, dhe si e tillë përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 22, pika 1.7 dhe 1.7a, lidhur me nenin 27 të LPP-së, për të qenë dokumentet të përmbartueshme dhe njëkohësisht të përshtatshme për përmbartim.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorëve sa i përket asaj që për shkak të pandemisë dhe gjendjes financiare të të njëjtëve nuk kanë arritur të përmbushin detyrimin e tyre në drejtim të kreditorit, mirëpo gjeti se pretendimet e tilla nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbartimor nga shkaqet taksative të përcaktuara me nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorëve ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 73, paragrafi 1 dhe 3 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2026/23, datë 20.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.